



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1016/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbare të kreditorit “Ontexi Mont “SH.P.K., me NRB: ..., me seli në Prishtinë Rr.”...” Veternik pn., kundër debitorit “Oda Ekonomike e Kosovës”, me NRB:..., me seli në Prishtinë Rr.”...” nr.20, të cilin e përfaqëson S. N. nga Prishtina, lagjja Ulpiana Rr.”...”, U2, Nr.10, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.970/21 të datës 25.08.2021, të Përmbaresit Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 15.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Oda Ekonomike e Kosovës, ANULOHET urdhri përmbare P.nr.970/21 të datës 25.08.2021, të Përmbaresit Privat Flamur S. Bogaj, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbaremi në këtë çështje përmbare.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat Flamur S. Bogaj me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Ontexi Mont SH.P.K., ka caktuar Urdhrin Përmbare P.nr.970/21 të datës 25.08.2021, duke lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm - faturës me numër 217 të datës 17.09.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në emër të borxhit sipas faturës së lartcekur, t'ia paguaj shumën prej 2,520.00 €, me kamatë ligjore prej 8 % në vit nga dita e kalimit të afatit për pagesën vullnetare deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh si dhe shpenzimet e procedurës përmbareme në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbaremit me dhunë.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar në tërësi propozimin për përmbaremi për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të nenit 71 të LPP-së.

Ka theksuar se kreditori nuk ka bazë juridike për të kërkuar përmbarrim, përkatësisht nuk është i autorizuar për të kërkuar përmbarrim, fatura në bazë të së cilës kërkohet përmbarrimi nuk i plotëson kriteret sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, në faturë nuk është treguar baza juridike për lëshimin e faturës. Po ashtu ka shtuar se fatura nuk është nënshkruar nga i autorizuari i debitorit e që debitori nuk e ka pranuar një faturë të tillë. Andaj i propozon gjykatës që ta pranoj prapësimin si të bazuar, shfuqizohet Urdhri Përmbarrimor P.nr.970/21 i datës 25.08.2021, dhe të përfundohet përmbarrimi në tërësi.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, ndër të tjerash ka theksuar se prapësimi nuk paraqet gjendjen reale faktike dhe ka tendencë që të paraqes një situatë e cila në fakt nuk ekziston. Ka shtuar se kontestimi i pranimi të faturës është i pa kuptimtë për faktin se në propozim për përmbarrim kemi bashkangjitur deklarin e z.B. R. i cili është kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës e i cili konfirmon dy faktet qenësore për këtë procedurë, e konstaton faktin e pranimi të faturës dhe e konstaton detyrimin financiar, pra pretendimet në prapësim janë të pa bazuara dhe janë tendencë të prolongojnë kreditorin të realizoj shumën të cilën debitori i ka detyrim. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës, që urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi si dhe të detyrohet debitori që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarrimore përfshirë edhe shpenzimet lidhur me ushtrimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit të përgjigjes në prapësim si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarrimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarrimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarrimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarrues ka lejuar përmbarrimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret - Fatura me numër 217 të datës 17.09.2020, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumentet fatura, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin apo vulën e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori në ndonjë mënyrë tjetër. Andaj, duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, si e tillë e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarimore.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe

nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm
KPPP.nr.1016/22, datë 15.11.2023

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.